



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



**DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
PRISHTINË**

Në bazë të nenit 11, 12 të Ligjit nr. 04/L-143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës, të nenit 5, shkronjes b) të Ligjit Nr. 03/L-068 Për Arsimin në Komunat e Republikës të Kosovës:

**Drejtoria e Arsimit
Shpall**

K O N K U R S

Për regjistrimin e vijuesve të rritur në arsimin e mesëm të lartë të arsimit profesional klasa X:

1. ShMEJ “Hoxhë Kadri Prishtina”

Drejtimet : Administratë: asistent juridik -32 vijues
Ekonomi : teknik i kontabilitetit - 32 vijues
Administrim biznesi : opsioni i financave -32 vijues
Ekonomi banka dhe sigurime - 32 vijues

2. ShMM “Shtjefën Gjeçovi”

Profilet:

1. Makineri:
-saldator: 25 vijues

Faqe 1 nga 5

- dirigjim komp.i makinerisë: 25 vijues
- automekanik: 25 vijues
- metalpunues: 25 vijues
- INGK: 25 vijues
- INUK: 25 vijues

2. Tekstil:

- konfeksioner: 25 vijues
- rrobaqepës: 25 vijues

3. Transport:

- transport rrugor: 25 vijues
- transport hekurudhor: 25 vijues

3.ShME "Gjin Gazulli"

Profilet:

- teknik i informatikës: 20 vijues
- teknik i telekomunikacionit: 20 vijues
- teknik i elektroteknikës: 20 vijues
- teknik për riparimin e pajisjeve të zyrave: 20 vijues
- teknik i elektroteknikës industriale: 20 vijues

5. ShMB "Abdyl Frashëri"

Drejtimi i bujqësisë

Profilet:

- mbrojtje e bimëve: 25 vijues
- hortikulturë: 25 vijues
- agrobiznes: 25 vijues

Drejtimi teknologji ushqimore

Profili:

- përpunues i mishit: 25 vijues
- furrtari: 25 vijues

Drejtimi i veterinės

Profili:

-veterinari: 25 vijues

6. ShMT “28 Nëntori”

Drejtimi:

PT : 28 vijues

Ndërtimtari:

- ndërtimtari: 25 vijues
- arkitekturë: 25 vijues
- gjeodezi: 25 vijues
- grafikë : 25 vijues
- post – telekom 25 vijues

7. SHMHT “7 Shtatori”

Drejtimi hoteleri

Profili:

- asistent i restorantit 25 – vijues
- gjellbërës - 25 vijues

Drejtimi turizëm

Profili:

- asistent i turizmit – 25 vijues

-REGJISTRIMI I VIJUESVE NË PROGRAMIN “Arsimi për të rritur”, bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt.

Në programin “Arsimi për të rritur” në shkollat e mesme të larta, vijuesve ju mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi (UA nr. 40/2006 MASHT).

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit, të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Dëftesat e klasave të kryera paraprake
2. Çertifikata e lindjes
3. Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të Udhëzimit administrativ, MASHT nr. 41/2006 dhe të Rregullores për të hyra vetanake të institucioneve arsimore të Komunës së Prishtinës.

Pagesa e vijuesve për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur në shkollat e mesme të larta profesionale do të jetë:

1. Për regjistrim të vitit për një klasë.....100.00
Euro
2. Për dhënien e provimeve plotësuese dhe diferenciale.....08.00
Euro
3. Për lëndët me shkrim dhe praktikë.....10.00
Euro
4. Pagesa e vijuesve për punën praktike do të bëhet varësisht nga drejtimi, në maksimum 50.00 Euro.

Pagesat bëhen në institucionet përkatëse edukativo-arsimore sipas kodeve të shkollave. Vijuesit, të cilët ndërrojnë profilin, do t’u nënshtrohen provimeve diferenciale, bazuar në UA 38/2006 MASHT.

Kandidatët, të cilët ndërrojnë drejtimin, janë të obliguar që paraprakisht t’u nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.

Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës, për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim.

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin “Arsimi dhe aftësimi për të rritur” janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Prishtinë, 11. 11. 2014